



In medias res

Nga duhet të shkojnë ndryshimet në arsimin e Kosovës?

Sistemi i arsimit, **paraqet kategorinë më propulzive** ekonomike, thonë ekonomistët. Ky, është alfa dhe omega e zhvillimit dhe të prosperiteti të përgjithshëm të shoqërisë. Nga cilësia e sistemit të edukimit varen shkathtësitë punuese dhe aftësitë e qytetarëve të Kosovës për të marrë pjesë aktive në ndarjen ndërkombëtare të punës dhe në tregun botëror të punës. Cilësia e arsimit përcakton shkallen e zhvillimit të dispozitave dhe të aftësive të qytetarëve të Kosovës të rëndësishme për zhvillimi ekonomik.

Pa edukim dhe arsim cilësor për të gjithë, Kosova nuk ka mundësi të shndërrohet në një "shoqëri të dije", nuk do të ketë "ekonomi të bazuar në dije", nuk do jetë në gjendje të bëjë "transferimin të dijeve dhe të teknologjisë së informacionit".

Treguesit botëror dëshmojnë në mënyrë të pakontestueshme se ekonomia e bazuar në dije, përkatësisht ekonomia e cila sot të bazohet në prodhimin, shpërndarjen dhe përdorimin e dije dhe të informacionit të drejtpërdrejtë janë shoqëri të dijeve sepse këto shoqëri investojnë në prodhimin dijeve të reja dhe të vlefshme, andaj dhe quhen "shoqëri të dije", ose siç parashikonte në mënyrë kozmogjike, gjeniu Uinston Churrchil shoqëria e sotme në planetin toku është duke u futur në kohën e "PERANDORISË TË DIJËS".

Ajo çka ne kosovarët duhet ta kuptojmë sa më parë është që tani e tutje punësimi, mirëqenia, zhvillimi njerëzor, bruto prodhimi nacional, kapitali social nuk do sigurohet me **duar** por me **kokë - mendje**, e cila mund të zhvillohet vetëm e vetëm me edukim dhe arsimim të fuqishëm, kreativ si në sistemin **formal**, ashtu edhe në atë **joformal** dhe **aformal**.

Sistemi i arsimit i Kosovës duhet të pësojë ndryshime të thella në mënyrë që të gjithë qytetarët e saj t'i posedojnë, t'i zhvillojë dhe të jenë në gjendje kudo-qoftë, kurdoherë dhe në çdo kohë t'i përdorin **gjashtë shkathtësitë e shekullit XXI**, pa të cilat nuk ka integrim të Kosovës në planin global, as krijim të **një shoqërie miqësore me njeriun në qendër**, e as realizim të **Objektiva të Mileniumi të Tretë**.

Këto gjashtë shkathtësi të shekullit XXI janë:

- ✚ Përgjegjësia personale dhe shoqërore (shkallë e lartë e pjesëmarrjes dhe përgjegjesisë së qytetarëve në jetën aktive në ndërtimin e shoqërisë)
- ✚ Planifikimi, mendimi kritik, rezonimi dhe kreativiteti
- ✚ Shkathtësitë për komunikim me të tjerët (portofoli e pasur e njohjes së gjuhëve rajonale dhe evropiane e botërore nga qytetarët e Kosovës)
- ✚ Të kuptuarit e kulturave të tjera
- ✚ Vizuelizimi dhe ndërmarrësia
- ✚ Njohuri, dhe shkathtësi për përdorimin e teknologjisë së re të informacionit dhe të arsimit

Po ta bëjmë një skanim-prerje të sistemit tashëm të arsimit të Kosovës me piketat e përmendura drejt të cilave duhet të shkojë ky sistem, shume lehtë do konstatohet se sistemi i tanishëm i arsimit jo vetëm që është para sfidave të mëdha, por është në diskrepancë të madhe me këto synime. Gjendja e tashme dhe modalitete e ndryshimeve do jenë në fokus të letrave të ardhshme informative

Shkroi: Halim Hyseni

Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSh

- Në muajin gusht është nënshkruar kontrata me zyrën e OSCE në Mitrovicë për të filluar trajnimin në Sh. F. "Isa Boletini" në fshatin Boletin të komunës së Mitrovicës. Në këtë trajnim do të marrin pjesë 25 mësimitdhënës.
- Po ashtu në javën e parë të shtatorit do të fillojë dhe trajnimi i 4 grupeve të mësimitdhënësve në komunën e Prizrenit. Ky trajnim është mundësuar në bashkëpunim me DKA në Prizren dhe financohet nga projekti i Bankës Botërore.

Hap pas Hapi

- Në gusht 21, 22, 26, 27, 28 në bashkëpunim me Balkan Sunflowers u mbajt trajnimi bazik për klasën e parë për tutorët dhe fascilitatorët të cilët punojnë me fëmijët e komunitetit ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës.



Qëllimi i trajnimit është që t'i mundësoj tutorëve dhe fascilitatorëve të aftësohen më mirë për punën të cilën ata kryejnë

me fëmijët gjatë aktiviteteve jashtë shkollimit të rregullt, duke njohur më mirë fazat e zhvillimit të fëmijëve dhe duke përshtatur aktivitetet për moshën të caktuar.

Së shpejti pritet të mbahet një trajnim i tillë edhe për pjesëmarrësit e komunitetit rom.

Shoqëria civile për pjesëmarrje të shtuar në arsim

- Në kuadër të këtij projekti më 8 korrik, në Prishtinë, u mbajt Konferenca Ndërkombëtare "Shoqëria Civile dhe Pjesëmarrja në Arsim". Në Konferencë morën pjesë 152 pjesëmarrës nga mbarë Kosova, si edhe përfaqësues nga Shqipëria, Bullgaria, Maqedonia, Kroacia, Hungaria dhe Sllovakia.

Konferencën e përshëndeti Z. Kjartan Bjornsson nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë (ECLC) dhe Z. Dukagjin Pupovci nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC).



Seanca plenare u mirëprit nga pjesëmarrësit ku prezantuan Gerda Sula nga Shqipëria, Eva Konkokova nga Sllovakia dhe Emil Buzov nga Bullgaria. Të gjitha prezantimet kishin të bëjnë me përvojën e shteteve përkatëse në lidhje me punën e shoqërisë civile për ta shtuar pjesëmarrjen e grupeve të marginalizuara në arsim.



Gjatë pjesës së dytë të konferencës pjesëmarrësit të ndarë në tre grupe punuese, debatuan për: 1) Edukimin parashkollor si faktor motivues për pjesëmarrje në arsim; 2) Strategjitë për parandalimin e braktisjes së shkollimit; dhe 3) Ndërlidhjen në mes të cilësisë në arsim dhe interesimit për arsim.

Me këtë konferencë edhe përfunduan aktivitetet e projektit “Shoqëria Civile për Pjesëmarrje të Shtuar në Arsim”, i financuar nga Komisioni Evropian dhe i zbatuar nga Qendra për Arsim e Kosovës në bashkëpunim me Sindikatën e Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, Shoqatën Kosovare për të Drejtat e Njeriut dhe Fëmijës dhe Shoqatën Ndërkombëtare Hap pas Hapi.

Projekti për përmirësimin e pjesëmarrjes në Arsim PPPA II

■ Në fillim të korrikut 2008 shkollat pjesëmarrëse në ciklin e dytë të PPPA II kanë përfunduar hartimin e projektet shkollore, të cilat bashkë me planet zhvillimore të shkollës janë dorëzuar për aprovim në Këshillin për Aprovimin e Granteve Shkollore (KAGSh). Paraprakisht këto projekte janë shqyrtuar dhe miratuar në nivel lokal nga Ekipet Komunale për Grante Shkollore (EKGSh). Më 26 gusht 2008, KAGSh ka vlerësuar

projektet shkollore dhe ka marrë vendim për miratimin e të gjitha projekteve. Pritet që pas nënshkrimit të kontratave për grantin, gjatë periudhës dymujore të realizohen këto projekte.

■ Ekipet planifikuese të projekteve nën udhëheqjen e Komiteteve Komunale për Grantin Arsimor (KKGA) kanë hartuar planet për zhvillimin e arsimit nëpër komuna dhe në një takim njëditor i cili është mbajtur në KEC i kanë prezantuar ato plane. Pas kësaj secila komunë pjesëmarrëse në projekt ka përgatitur një projekt-propozim. Edhe në përgatitjen e këtyre projekteve, komunat kanë pasur ndihmën e bashkëpunëtorëve profesionalë të terrenit. Pritet që planet për zhvillimin e arsimit në komunë dhe projekt-propozimet të miratohen nga asambltetë komunale dhe pastaj të dërgohen në KAGSh për aprovim..

Monitorimi i implementimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve RAE në arsim

■ Sipas planifikimit të aktiviteteve të projektit “Monitorimi i Implementimit të Strategjisë së Komuniteteve Rom, Ashkalinj dhe Egjiptian” në Kosovë, gjatë muajit korrik u mbajt një punëtori njëditor ku pjesëmarrës ishin struktura të ndryshme që punojnë për këto komunitete. Në fillim të muajit shtator është paraparë të bëhet prezantimi/diskutimi publik i Raportit të monitorimit të parë të kësaj Strategjie, i cili raport do ti dërgohet MASHT-it pas këtij diskutimi.

■ Në kuadër të këtij projekti gjithashtu është paraparë mbajtja e aktiviteteve sociale me fëmijët e këtyre komuniteteve.

Aktiviteti social në Pejë: Kampi njëditor me fëmijët e komunitetit RAE, kryesisht fëmijë të shkollës “Pjetër Budi” në Pejë. Fëmijët ishin të moshës 11-16 vjeç.



Aktiviteti u zhvillua në parkun e qytetit të Pejës ku fëmijët patën kushte dhe mundësi më të madhe loje. Në këtë kamp u zhvilluan lojëra të ndryshme sporti. Pjesëmarrës ishin rreth 30 fëmijë të këtij komuniteti të shoqëruar me mësime të tyre.

Aktiviteti social në Prizren: Në Prizren u zhvillua po ashtu një aktivitet social me fëmijë të Komunitetit Rom. Pjesëmarrja e tyre ishte mjaft e madhe me rreth 35 fëmijë. Ky aktivitet u zhvillua në parkun e qytetit të Prizrenit. Si aktivitet për këta fëmijë ishte zgjedhur një formë tjetër e cila kishte të bëjë me pikturimin. Të gjithë fëmijët u pajisën me mjete për pikturim dhe në grupe ose të vetëm, sipas dëshirës filluan punimet e tyre. Punimet e bëra nga fëmijët iu dhanë qendrës për komunitete të Prizrenit.



Mentorimi i projekteve për përkrahje të arsimimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

■ Në kuadër të këtij projekti, në fillim të korrikut KEC ka organizuar trajnimin fillestar “Edukimi për të Drejtën Shoqërore” për mësime të shkollës “Yll Morina”, “Mustafa Bakija” e “Emin Duraku” në Gjakovë, “Naim Frashëri” në Zaskok (Ferizaj) dhe “Mustafa Baku” në Prizren. Që të gjithë këta mësime punojnë në klasat ku vijojnë mësime fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Trajnimi ka qenë tregues dhe në fund të tij janë certifikuar 20 pjesëmarrës.

■ Një tjetër trajnim është organizuar në muajin gusht, më saktësisht, me datat 21-22 dhe 26-28. Kësaj radhe, KEC në bashkëpunim me Ballkan Sunflowers ka organizuar trajnimin “Hap pas Hapi për facilitatorë”. Në këtë trajnim, që është mbajtur në Fushë Kosovë, janë përfshirë 35 vetë që punojnë me fëmijët në qendrat e komunitetit. Nga gjithsej 35 pjesëmarrës, në trajnim kanë marrë pjesë 7 facilitatorë që punojnë në Qendrat e komunitetit në Gjakovë, Prizren e Dubravë që mentorohen nga KEC. Në fund të trajnimit pjesëmarrës të gjithë pjesëmarrësit u certifikuan. Në këtë trajnim, pjesëmarrësit janë njoftuar për mënyrat e punës me fëmijë gjatë orëve të mësimit shtesë si dhe punës me detyrat e shtëpisë.

Access Microscholarship Program

■ Muaji Korrik, muaj i cili me certifikimin e nxënësve nga Prizreni, përfundoi aktivitetet e veta. Po ashtu është punuar edhe raporti final i këtij projekti i cili raport do të dorëzohet Ambasadës Amerikane deri në fund të këtij muaji. Dhe shpresojmë që ky raport do të sjell edhe

programin tjetër dy-vjeçar, për mundësinë e fëmijëve tjerë në mësimin e gjuhës angleze.

KOSOVISION Contest

Kosovision Contest është një projekt arsimor në Kosovë i cili do të filloj implementimin në shtator të vitit 2008 dhe do të zgjas deri në maj të vitit 2011. Ky projekt është një projekt medial arsimor në formë të një gare kombëtare në mes të shkollave fillore të Kosovës. Projekti përfshin nxënësit e klasave të pesta nga të gjitha etnitetet e Kosovës. Kosovision Contest është projekt i shkollës së Lartë Pedagogjike të Cyrihut dhe realizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Qendrën për Arsim e Kosovës dhe Radio Televizionin e Kosovës.

AVSI-CESAL

Qendra për Arsim e Kosovës ka filluar bashkëpunimin edhe me një organizatë nga Madridi që punon dhe vepron në Kosovë. Në bashkëpunim me këtë organizatë, KEC do të bëjë një hulumtim ku do të përfshihen të gjithë mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave fillore nga Rajoni i Pejës dhe ai i Gjakovës. I gjithë projekti do të zgjas gjashtë muaj ku përveç hulumtimit do të bëhen edhe trajnime me mësimdhënësit dhe me drejtorët e shkollave. Qëllimi i këtij hulumtimi është që të shihet cilësia e arsimit dhe përfshirja e komuniteteve të tjera në sistemin arsimor të Kosovës.

Përgatiti: Petrit Tahiri